



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°24/2022

Hagë, 23/06/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Salih Mustafa*, më 20 qershor Trupi Gjykses deklaroi mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave dhe urdhëroi që brenda datës 21 korrik, Mbrojtja dhe Prokuroria të dorëzojnë dosjet e tyre gjyqësore përfundimtare ndërsa mbrojtësja e viktimave të dorëzojë deklaratën e vet lidhur me ndikimin që kanë pasur krimet e pretenduara te viktimat. Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëroi që deklaratat përmblyëse të mbahen mes datave 13 dhe 15 shtator, ndërsa 16 shtatori do të jetë si ditë rezervë.

Më 21 qershor, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me njoftimet për apel të dorëzuara nga Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kundër Aktgjykimit të 18 majit. Të akuzuarit kërkojnë prapësim të verdiktit të fajësisë së tyre, ose ulje të dënimit, në qoftë se verdiktet e fajësisë mbeten në fuqi.

Në Aktgjykim, Trupi Gjykses i shpalli dy të akuzuarit fajtorë për frikësim gjatë procedurës penale, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Trupi Gjykses i shpalli dy të akuzuarit të pafajshëm për akuzën e hakmarrjes, të paraqitur në Aktakuzë.

Trupi Gjykses dënoi secilin nga të akuzuarit me katër vjet e gjysmë burgim dhe një gjobë prej 100 eurosh secili.

Më 22 qershor, Kryegjykatësja e panelit të Gjykatës së Apelit caktoi datën 5 korrik për të mbajtur një konferencë para apelit. Kjo do të jetë një seancë publike, gjatë së cilës, në bazë të Rregullores së Procedurës dhe Provave, çdo personi të paraburgosur në





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°24/2022

Hagë, 23/06/2022

pritje të apelit i jepet mundësia të ngrejë çështje lidhur me apelin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit.

Javën e shkuar, ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim organizoi aktivitete në Kosovë, në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile, u angazhua me audiencën në komunitetet lokale rreth zonës së Gjilanit si dhe bisedoi me avokatë, pedagogë dhe studentë të juridikut në Mitrovicë, Prizren dhe Gjilan. Deri më tani, DHSK-ja ka mbajtur 20 takime bashkëbiseduese me njerëz anembanë Kosovës.

Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje

